

Tryezë e Rrumbullakët

Mbledhja e 10^{të} e Grupit Kombëtar të Punës për RAP

Konsultimi i draftit të Udhëzimeve për Zgjidhjen e Problemeve të Qytetarëve nëpërmjet RAP dhe përzgjedhja e tematikave të RAP, me përparësi për shoqërinë civile dhe qytetarët

24 nëntor 2023, ora 10:00 – 14:00, Hotel Tirana International, #WeBER-G-03

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizon mbledhjen e dhjetë të Grupit Kombëtar të Punës (GKP) për Reformën në Administratën Publike (RAP). Mbledhja organizohet në vijim të shpalljes së thirrjes së tretë për projekt-propozime për instrumentin e granteve të vogla “Angazhimi i qytetarëve në nivelin lokal të RAP”, të projektit WeBER 3.0, e hapur për aplikime deri më 28 dhjetor 2023.

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) anëtare të GKP-së dhe organizata të tjera të interesuara ftohen të marrin pjesë në konsultimin e “Draftit të Udhëzimeve për Zgjidhjen e Problemeve të Qytetarëve nëpërmjet RAP”. Drafti është pjesë e Thirrjes për Propozime dhe udhëzon modalitetet e zgjidhjes së problemeve praktike të administratës publike në nivelin vendor që ndeshin qytetarët në përditshmërinë e tyre. Përmirësimi i draftit nga kontributi i OShC-ve lokale, do të lehtësojë hartimin e projekt-propozimeve të aplikantëve të interesuar për të marrë pjesë në Thirrjen për Propozime, dhe eventualisht edhe në zbatimin e projekteve fituese.

Konsultimi i Udhëzimeve do të pasohet nga diskutimi për çështjet e tematikat e RAP që duhet të kenë përparësi, sipas pikëpamjes së OShC-ve të angazhuara në terren dhe në kontakt me qytetarët. Në përfundim të diskutimit, anëtarët e GKP-së dhe OShC-të e tjera pjesëmarrëse do të udhëzojnë renditjen sipas rëndësisë së tematikave të RAP, të cilat do të trajtohen në vijim të projektit nga skuadra WeBER.

IDM lehtëson procesin e pjesëmarrjes së OShC-ve lokale në mbledhje, duke ofruar mbulimin e shpenzimeve të transportit dhe akomodimit në rast nevojë.

Për arsye logjistike, të interesuarit luten të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre brenda datës 22.11.2023 në adresën bkola@idmalbania.org.

Projekti WeBER 3.0 “Nxitja e Reformimit të Administratave Publike të Ballkanit Perëndimor”, zbatohet nga Rrjeti Think for Europe dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim.

PROGRAMI

09:45 – 10:00 **Regjistrim**

10:00 – 10:30 **Mirëseardhje**

Znj. Bora Kola, Koordinatore projekti, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Prezantim: Drafti i Udhëzimeve për Zgjidhjen e Problemeve të Qytetarëve nëpërmjet Reformës në Administratën Publike

Znj. Iliada Korçari, Hulumtuese, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

10:30 – 11:15 **Diskutim i hapur mes pjesëmarrësve**

11:15 – 11:35 **Pushim kafeje**

11:35 – 12:30 **Diskutim:** Çështjet parësore të Reformës në Administratën Publike për qytetarët dhe renditja e përparësisë së tyre sipas këndvështrimit të anëtarëve të Grupit Kombëtar të Punës

Diskutim i hapur mes pjesëmarrësve

Moderon: **Znj. Iliada Korçari**, Hulumtuese, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

12:30 – 12:40 **Përfundime dhe njoftime për Thirrjen për Propozime**

12:40 – 14:00 **Drekë dhe rrjetëzim**
